



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4804 Prot.

Fushë-Arrëz, më 31 / 12. 2024

V E N D I M

Nr. 67, datë 23.12.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE "IBALLE-MEZI 1&2"
NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ"**

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" ; Ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet", neni nr.11, pika 2, germa b ; VKM-në nr.134 date 3.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të këshillit të ministrave "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive" ; Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot, datë 30.01.2019", Shkreses së Bashkisë Fushë-Arrëz Nr.1639 prot datë 17.05.2024 "Kërkesë për mbështetje teknike për hartimin e Planeve të Mbarshtrimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Fushë-Arrëz" ; Shkreses së Fakultetit të Shkencave Pyjore (UBT) nr.378/1 prot datë 02.09.2024 "Përgjigje ndaj kërkeses së Bashkisë Fushë-Arrëz për mbështetje teknike për hartimin e Planeve të Mbarshtrimit të Pyjeve dhe Kullotave" ; Marrveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës (Nr.2534 prot datë 10.09.2024) dhe Bashkisë Fushë-Arrëz (Nr.2868 datë 10.09.2024); Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz, në mbledhjen e datës 23.12.2024, pasi shqytoi projekt vendimin me 11 këshilltarë të pranishëm,

V E N D O S I

1. Miratimin Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore "Iballe-Mezi 1&2" për vijimin e procedurave për miratimin e tij nga Ministria e Mjedisit dhe Turizimit sipas Ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet", neni nr.11, pika 2, germa b.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.

Miratuar me: 11 vota Pro 0 Vota Kundër 0 Vota Abstenim

Zbardhur më datë: 31/12 /2024.

Bashkëlidhur këtij Vendimi është relacioni shpjegues për hartimin e Planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore "Iballe-Mzi 1&2".

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al